



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 11/02
Datë: 15.02.2012

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 3, 4, 5 dhe nenit 49 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Vala të bëjë asgjësimin e të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimi të të dhënave personale.
2. Asgjësimi i tyre duhet të bëhet deri më 15. 04. 2012
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit është konstatuar që operatori i telefonisë mobile Vala gjatë regjistrimit të abonentëve depoziton kopje të dokumenteve personale, andaj siç është specifikuar në nenin 3 pika 2, 3, 4, dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, depozitimi i këtyre të dhënave e ka tejkaluar qëllimin për të cilin përpunohen. Pas kontrollit të datës 13.02.2012 në operatorin mobil Vala për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit Nr. 02/12 të datës 22.12.2011, është konstatuar se operatori i telefonisë mobile Vala i duhet kohë shtesë për të asgjësuar të gjitha kopjet fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimit të të dhënave personale.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik



Mentor Hoxhaj
Mentor Hoxhaj
Bekim Demjri
Bekim Demjri
Bekim Spasic
Bekim Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Vala
- Arkivit të Agjencisë